



DEKLARATA E INVERURISË 2025

Ne, banorët e komuniteteve rurale, kemi çelësat e zgjidhjeve që i duhen Evropës. Vijnë nga të gjithë brezat dhe nga çdo cep i Evropës rurale: të rinj e të moshuar, gra e burra, të lindur këtu dhe të ardhur, nga kontinenti dhe ishujt, nga brigjet, luginat dhe malet.

Ne jemi të aftë. Ne jemi komunitete të forta. Ne krijojmë zgjidhje të rëndësishme për jetën në komunitet, në terren. Ne jemi dhe kemi atë që e mban Evropën konkurruese, solidare dhe të qëndrueshme.

Ne kërkojmë njohje, mbështetje dhe partneritet të vërtetë - jo pengesa që ngadalësojnë ndryshimin që ne tashmë po e udhëheqim.

Në frymën e këtij partneriteti, të forcuar përmes procesit të Parlamentit Rural Evropian, ne angazhohemi të vazhdojmë:

- Të ruajmë traditat dhe kulturën tonë, duke nxitur njëkohësisht inovacionin që ndërton komunitete të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse si bazë për prosperitetin e Evropës, sigurinë ushqimore, sigurinë klimatike, kohezionin social, ripërtëritjen demokratike dhe paqen.
- Të punojmë së bashku dhe përtej kufijve për ndryshime domethënëse të udhëhequra nga komuniteti, me besim në aftësinë tonë për të formësuar të ardhmen dhe të gatshëm për të artikuluar qartë çfarë duam dhe si e përfytyrojmë.
- Të veprojmë për një Europë më të drejtë, më të gjelbër dhe më demokratike, të bazuar në solidaritet dhe angazhim.
- Të krijojmë hapësira gjithëpërfshirëse ndërbreznore, ku secili mund të mësojë, kontribuojë dhe të marrë pjesë në formësimin e zgjidhjeve që u duhen zonave tona rurale.
- Të sigurojmë pjesëmarrjen sa më të larmishme të qytetarëve në dialog dhe vendimmarrje, veçanërisht të atyre që zakonisht dëgjohen më pak.
- Të zhvillojmë modele sipërmarrje të udhëhequra nga komuniteti, sociale dhe mikro, që mbështesin ekonominë sociale, krijojnë vlerë dhe vende pune në nivel lokal.
- Të fuqizojmë njerëzit për të zotëruar aftësitë digjitale dhe për të përqafuar tranzicionin teknologjik.
- Të thellojmë bashkëpunimin dhe solidaritetin mes fshatrave, komuniteteve, organizatave dhe territoreve.

Ne nuk kërkojmë ndihmë; kërkojmë mbështetje në partneritet. Kemi nevojë që ju, autoritetet evropiane, kombëtare dhe rajonale, të hiqni pengesat që na mbajnë pas dhe të siguroni burimet dhe mbështetjen që na fuqizojnë për të vepruar.



Nga ana tjetër, ne kërkojmë që të gjitha nivelet e qeverisjes - evropiane, kombëtare dhe rajonale - të veprojnë së bashku dhe të punojnë me ne, për të:

- Zbatuar në mënyrë sistematike “*rural proofing*” në të gjitha politikat dhe rregulloret, duke njohur se kjo nuk është një ushtrim formal, por një proces që integron zërat ruralë në çdo fazë të hartimit dhe zbatimit të politikave, nga konsultimi te vendimmarrja dhe vlerësimi.
- Përfshirë zërat ruralë në çdo fazë të politikëbërjes, hartimit dhe zbatimit, nga konsultimi te vendimmarrja dhe vlerësimi.
- Garantuar programe financimi afatgjata, të aksesueshme, fleksibël dhe transparente që arrijnë komunitetet dhe mbështesin ndikimin social.
- Tejkualuar paradigmën e rritjes së pakufizuar dhe të prioritetizohet qëndrueshmëria, nevojat lokale dhe krijimin e pasurisë në nivel vendor në modelet ekonomike dhe të investimeve, për të siguruar që mirëqenia të jetë e shpërndarë dhe afatgjatë.
- Forcuar kapacitetet lokale, lidhësin dhe sipërmarrjen përmes aftësive teknike dhe digjitale, por edhe përmes arsimit dhe mundësive të të mësuarit që shfrytëzojnë kreativitetin dhe pasionin e të rinjve, duke krijuar mundësi që ata të jetojnë mirë në komunitetet e tyre rurale dhe si pjesë e tyre.
- Lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve, sektorëve dhe institucioneve, duke mundësuar shkëmbim, inovacion dhe solidaritet përtej kufijve administrativë.
- Rikonceptuar proceset e kërkimit në zonat rurale, në mënyrë që ato të drejtohen nga komuniteti, të formësohen prej tij dhe të sjellin përfitime të drejtpërdrejta për zonat rurale.

Ne i bëjmë thirrje Bashkimit Evropian që:

- Të shndërrojë Vizionin Afatgjatë për Zonat Rurale dhe Planin e Veprimit të Paktit Rural në veprime konkrete, të mbështetura me burime të mjaftueshme.
- Të mbështesë në mënyrë aktive të gjitha vendet që synojnë anëtarësimin dhe të bashkëpunojë ngushtë me vendet fqinje që kërkojnë lidhje të forta.
- Të sigurojë që politikat e integruara, të bazuara në territor dhe të udhëhequra nga komuniteti për zonat rurale dhe territoret, të mbeten në thelb të politikave territoriale, bujqësore, detare dhe sociale të BE-së.
- Të garantojë dhe të zgjerojë financimin për zonat rurale, duke përfshirë instrumente territoriale si LEADER/CLLD dhe *Smart Villages* si të detyrueshme në kuadrot e ardhshme të politikave.
- Të njohë jo vetëm të drejtën për të qëndruar dhe për t’u kthyer në fshat, por edhe të drejtën për lëvizje për fuqinë punëtore rurale, duke siguruar që banorët ekonomikisht aktivë të kenë akses në punë, trajnime dhe mundësi në të gjithë rajonet.
- Të garantojë zbatimin efektiv të Parimit të Partneritetit, për të siguruar qeverisje transparente, gjithëpërfshirëse dhe shumë-nivelëshe në të gjitha nismat me dimension rural.

Ne u bëjmë thirrje autoriteteve kombëtare dhe rajonale që:

- Të njohin komunitetet rurale si mbajtëse dhe kujdestare të aseteve kryesore dhe si aktorë të rëndësishëm në ndërtimin e reziliencës, reagimin ndaj krizave dhe proceset e tranzicionit.



- Të angazhohen plotësisht ndaj Vizionit Afatgjatë për Zonat Rurale, me strategji të qarta dhe buxhete të mjaftueshme të përshtatura me realitetet lokale.
- Të investojnë në ndërtimin e kapaciteteve lokale, duke zhvilluar si aftësitë e buta ashtu edhe ato teknike, dhe duke fuqizuar njerëzit në zonat rurale për të nxitur sipërmarrjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- Të ndalojnë ndërprerjen e shërbimeve dhe trendet negative demografike të largimit të burimeve njerëzore nga zonat rurale dhe ato me popullsi të rrallë.
- Të promovojnë një mendësi pozitive për jetën rurale dhe të forcojnë marrëdhëniet komunitare, për të tërhequr dhe mbajtur banorë, talente dhe investime.

Ne kërkojmë veprim. Ndryshimi sistemik është i domosdoshëm, por thirrja për ndryshim sistemik nuk duhet të shërbejë kurrë si justifikim për vonesa. Koha për të vepruar është tani. Së bashku, përtej brezave dhe kombeve, ne kemi fuqinë për të marrë dhe zbatuar vendimet që do të formësojnë të ardhmen që duam dhe meritojmë.

Brez i ri dhe brez i vjetër,
një jemi - të fortë, të vërtetë
Nga e shkuara mësojmë, për të ardhmen ndërtojmë,
dhe atë e përcjellim më tej.
Jemi një - dëgjojeni zërin tonë.

Më shumë informacion: <https://europeanruralparliament.com/>

Kontakt: info@europeanruralparliament.com